

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7116
E martë, 13 shkurt 2024
Çmimi 0.50

Dorëzohet edhe BQK-ja,
shtynë tre muaj vendimin
për dinarin | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

221 PJESËTARË TË FSK-së U LARGUAN GJATË VITIT TË KALUAR | FAQE 5



Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije të hënën se 221 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) e kanë braktisur këtë

institucion gjatë vitit të kaluar, duke përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë dhe nëpunës civilë. Sipas tij, më shumë se gjysma prej tyre janë

larguar për mundësi jashtë FSK-së, duke lëvizur nëpër institucione të tjera. Një ndër arsytet ai ka përmendur edhe shkakun e pagave

**TAHIRI:
VITI I KATËRT
I QEVERISJES
KURTI, NUK JANË
NË GJENDJE TA
SJELLIN NË
KUVEND LIGJIN
PËR SIGURIME
SHËNDETËSORE | F.7**



**MITROTAKIS NË BEOGRAD:
NUK KEMI NDRYSHUAR
QËNDRIMIN KARSHI KOSOVËS | F.3**



OPINION

**PSE NUK DUHET TË VOTOHET
TRAKTATI PËR BURGJE MIDIS
DANIMARKËS DHE KOSOVËS | F.7**

Reagim i KMDLNj-së



POEZI

**MEDITIM I PAJTUESIT
TË GJAOQEVE | F.7**

/Pesë nismëtarëve të 29 janarit 1990, ish të burgosur politikë,-Myrvetes, Haves, Ademit, Ibrahimit dhe Lulëzimit (Etemaj)/

Muhamet
MAVRAJ



AKTUALE



**TRUPI GJYKUES VENDOS QË MOS TË
KETË KUFIZIME NË VIZITAT PRIVATE
PËR TË AKUZUARIT NË ÇËSHTJEN
THAÇI DHE TË TJERËT | F.5**

**DITA NDËRKOMBËTARE E EPILEPSISË,
MBAHET SIMPOZIUM PËR
SËMUNDJEN E EPILEPSISË | F.7**

KËTË JAVË DY SEANCA PLENARE | F.5

EKONOMI

**ATK-JA: JANARI ME 4.26 MILIONË
EURO TË HYRA MË SHUMË SE PLANI | F.8**

**KOSOVA DHE SHOIPËRIA
DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIMIN
NË FUSHËN E BIZNESIT | F.8**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Borrelli: NATO s'mund të jetë një aleancë ku mund të zgjedhësh çfarë të duash

BRUKSEL, 12 SHKURT - NATO "nuk mund të jetë një aleancë a la carte [v.j. mundësia e zgjedhjes sipas dëshirës nga një meny]". Kështu tha më 12 shkurt shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pasi Donald Trump minimizoi përkushtimin e tij ndaj ombrellës së sigurisë së NATO-s në Evropë nëse do të zgjidhej sërish president. Deklaratat e Trumpit nxitën reagime në aleatët evropianë të Shteteve të Bashkuara. Ish-presidenti amerikan tha se ai do ta "inkurajojë" Rusinë që ta sulmojë çdo shtet të NATO-s që nuk

pëmbush obligimet e tij financiare ndaj aleancës. "Të bëhemi seriozë. NATO nuk mund të jetë një aleancë ushtarake a la carte. Nuk mund të jetë një aleancë ushtarake që punon sipas tekave të përditshme të presidentit amerikan", tha Borrelli. "Ose ekziston ose jo", tha ai, duke shtuar se nuk do të komentojë më "asnjë budallallëk" që do të dalë nga fushata zgjedhore presidenciale amerikane.

Deklaratat e Trumpit - i cili kur ishte në pushtet e tërhoqi ShBA-në nga marrëveshja bërthamore me Iranin dhe nga marrëveshja për



klimën e Parisit - nxitë reagimin e presidentit aktual Joe Biden.

Bideni tha se deklaratat e paraardhësit të tij ishin "të tmerrshme dhe të rrezikshme".

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, më 11 shkurt paralajmëroi se "çdo sugjerim që aleatët nuk do ta mbrojnë njëri-tjetrin minon të gjithë sigurinë tonë, përfshirë edhe të ShBA-së".

Trumpi, 77 vjeç, konsiderohet kandidati kyç për fitimin e nominimit për garën presidenciale nga republikanët, duke rritur gjasat për një përballje në zgjedhje me presidentin demokrat Joe Biden.

Shefi i Pentagonit në spital, ia transferon kompetencat zëvendësues së tij

WASHINGTON, 12 SHKURT - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, është shtruar në një repart të kujdesit kritik për shkak të problemeve me fshikëzën, duke ia transferuar përgjegjësitë zëvendësues së tij, tha Pentagoni të dielën.

Austin po përballet me kancer në prostatë.

Nënshefja amerikane e Mbrojtjes, Kathleen Hicks, "mori funksionet dhe përgjegjësitë" pak para orës 17:00, sipas kohës lokale, tha zëdhënësi i Pentagonit, Pat Ryder, përmes një deklaratë, duke shtuar se për këtë janë njoftuar Shtëpia e Bardhë dhe Kongresi.

Austin është "pranuar në një njësi të kujdesit kritik në Qendrën Kombëtare Spitalore Ushtarake Walter Reed për mbështetje shëndetësore dhe monitorim",



tha Pentagoni përmes një deklaratë tjetër, duke cituar mjekët e tij.

Ky njoftim rreth shëndetit të shefit të Pentagonit vjen pasi Austin, 70 vjeç, paraprakisht kishte mbajtur sekret shtrimin në spital dhe nuk kishte njoftuar menjëherë presidentin amerikan, Joe Biden,

për diagnozën e tij me kancer, duke nxitur kritika pasi ShBA-ja po përballet me krizat në Lindjen e Mesme dhe Ukrainë.

Austin ishte zhdukur nga syri i publikut gjatë trajtimit për kancerin në prostatë në dhjetor dhe më pas në janar, pasi kishte pasur ndërlikime gjatë një

procedure.

Këtë herë publiku u njoftua dy orë pasi ai u dërgua në spital të dielën pasdite.

Austin "u transportua nga ekipi i tij i sigurimit" në spital, tha Ryder përmes deklaratës. Ky zëdhënës fillimisht tha se shefi i mbrojtjes mori me vete sisteme të klasifikuara të komunikimit dhe do t'i mbante detyrat.

Por, në njoftimin e dytë u bë me dije se Hicks do ta merrte përgjegjësitë e Austinit.

"Aktualisht nuk është e qartë se sa do të qëndrojë në spital sekretari Austin", u tha në deklaratën e fundit të Pentagonit, që iu referua dr. John Maddox dhe dr. Gregory Chesnut nga spitali Walter Reed që gjendet në Marilend.

Muajin e kaluar Austin kishte kërkuar falje pasi u përball me kritika se kishte mbajtur sekret

shtrimin paraprak në spital. "Është dashur që ta njoftoja presidentin për diagnozën time me kancer", u tha ai gazetarëve më 1 shkurt.

Shtrimi i tij në spital po ndodh në kohën kur ShBA-ja po përballet me krizat në Lindjen e Mesme, ku forcat amerikane në Irak dhe Siri pothuajse përditë po përballet me sulme nga militantët e mbështetur nga Irani në shenjë hakmarrjeje ndaj mbështetjes së Uashingtonit për Izraelin.

Zyrtari më i lartë i mbrojtjes në ShBA, po ashtu, është figurë kyçe në përpjekjet e administratës Biden për ta vazhduar mbështetjen për Ukrainën në luftën e saj kundër pushtimit rus, përdërisa ligjvënësit republikanë në Kongres po refuzojnë ta miratojnë ndihmën e re ushtarake për Kievin.

Ukraina përballet me një valë të re të sulmeve ajrore ruse

KIEV, 12 SHKURT - Ushtria e Rusisë ka kryer sulme të reja me dronë në Ukrainë gjatë natës, ndërkaq Forcat Ajrore ukrainase raportuan më 12 shkurt se sistemet e mbrojtjes ajrore kanë shkatërruar 14 nga 17 dronët rusë si dhe një raketë lundruese të llojit Kh-59.

Forcat Ajrore, po ashtu, thanë se ushtria ruse ka lëshuar raketa tokë-ajër të llojit S-300, të cilat kanë rreze të gjatë veprimi, por nuk treguan se sa raketa të këtij lloji u lëshuan dhe nëse ndonjëra prej tyre ka goditur ndonjë cak.

Gubernuratori i rajonin verilindor ukrainas të Harkivit, Oleh Synehubov, në orët e vona të 11 shkurtit deklaroi se Rusia ka sulmuar këtë rajon me raketa që janë lëshuar nga rajoni rus i

Belgorodit, që gjendet në kufi me Ukrainën.

Sipas raporteve preliminare, Synehubov tha se nuk ka viktima, por disa ndërtesa jorezidenciale kanë pësuar dëme.

Ndërkaq guvernatori i Dnipropetrovskit, Serhiy Lisak, deklaroi të dielën mbrëma se Rusia ka sulmuar qytetin rajonal Pavlorad me dronë. Nuk raportohet për viktima por, sipas guvernatorit, një pjesë e qytetit të goditur ka mbetur pa energji elektrike.

Vala e fundit e sulmeve ruse me dronë po ndodh në kohën kur presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky po vazhdon të bëjë ndryshime në kabinetin e tij të luftës përdërisa pushtimi rus i



Ukrainës po i afrohet përvjetorit të dytë.

Kievi njoftoi më 11 shkurt se Oleksandr Pavlyuk - që ditë më

parë u lirua nga detyra e zëvendësministrit të Mbrojtjes - është emëruar në pozitën e komandantit të forcave tokësore të

Ukrainës.

Kjo pozitë paraprakisht ishte mbajtur nga gjeneralkoloneli Oleksandr Syrskiy, i cili më 8 shkurt u emërua komandant i përgjithshëm i ushtrisë ukrainase, duke zëvendësuar gjeneralin Valeriy Zaluzhnyi.

Në Uashington, gjatë një seance të mbajtur më 11 shkurt, Senati votoi për të lëvizur përpara me paketën në vlerë prej 95.3 miliardë dollarësh për ndihmë për Ukrainën, Izraelin dhe shtetet e tjera.

Në këtë paketë është paraparë që 60 miliardë dollarë të jenë ndihmë ushtarake për Ukrainën. Nëse Senati nuk e miraton paketën, do të mbetet e paqartë nëse ajo mund të kalojë në Dhomën e Përfaqësuesve.

Tahiri: Viti i katërt i qeverisjes Kurti, nuk janë në gjendje ta sjellin në Kuvend Ligjin për Sigurime Shëndetësore

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 12 shkurt - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e cila është mbajtur të hënën, janë trajtuar agjendat dhe temat që janë protokollare dhe administrative por, sipas tij, nuk janë trajtuar temat që janë jetike dhe për të cilat do të duhej një reagim i kësaj qeverie. Ai ka thënë se të mërkurën është 14 shkurti. "Po në këtë datë të vitit 2021 LV-ja i fitoi zgjedhjet. Ndërkaq të enjten hyjmë në vitin e katërt të kësaj qeverie. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të ngrehë tema jetike përmes tri iniciativave: Sigurimet shëndetësore, Ligji i Pagave në sektorin publik dhe paga minimale në sektorin privat", ka thënë Tahiri.

Duke folur për sigurimet shëndetësore, Tahiri ka thënë se si grup parlamentar kanë mbledhur nënshkrimet për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme për Ligjin për Sigurimet Shëndetësore. "Nëse i sëmuret dikujt fëmija, prindi apo një anëtar i familjes, të gjitha kursimet që i ka duhet t'i shkrijë, të hyjë borxh për ta shëruar të sëmurin. Po hyjmë në vitin e katërt të qeverisjes dhe nuk janë në gjendje ta sjellin në Kuvend Ligjin për Sigurime Shëndetësore. Kjo do të jetë çështja që do të punojmë dhe të krijojmë një konsensus ndërpartiak. Si AAK kemi votuar shumë ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare dhe mendojmë se



është jetike për qytetarin e Kosovës që siguri shëndetësor të kalojë në këtë legjislaturë dhe të fillojë zbatimin e tij", ka thënë ai. Ndërkaq sa i përket Ligjit të Pagave në sektorin publik, ai ka thënë se me këtë ligj nuk përcaktohet vlera koeficientit, respektivisht paga e një zyrtari publik, por vetëm hierarkia. "Ne do të punojmë që përmes amendamentimit të këtij ligji t'i bëjmë dy intervenime: ta rirregullojmë hierarkinë e pagës dhe ta përcaktojmë vlerën e koeficientit. Në sektorin publik paga mesatare duhet të jetë 1 000 mijë euro, ndërkaq paga më e ulët nuk duhet të jetë nën 450 euro", është shprehur ai.

Sa i përket pagës minimale në sektorin privat, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka theksuar se AAK-ja e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese trajtimin e çështjes së Ligjit për Pagën Minimale në sektorin privat. Sipas tij, pas përfundimit të kësaj nga ana e Kushtetueses, do të fillojnë amendamentimin e Ligjit për Pagën Minimale. "Në seancën e fundit kam folur për suficitin buxhetor të kësaj qeverie që ka arritur në 1 miliard e 125 milionë euro. Pra, jemi duke folur për një qeveri të paaftë, e cila, për t'i mbuluar dështimet e veta kardinale në jetën qytetare, bën eksperimente të cilat e kanë sjellë

Kosovën me sanksione të BE-së dhe marrëdhëniet më të ulëta me bashkësinë ndërkombëtare", është shprehur Tahiri.

Në interesimin e medieve lidhur me provokimet e shtetit të Serbisë, Tahiri ka thënë se agjenda armiqësore e Qeverisë së Serbisë ndaj Kosovës nuk do të ndalet. "Pra, synimi i tyre është destabilizimi i Kosovës. AAK-ja i ka qëndrimet për këtë temë: sundimi i ligjit, shtrirja e sovranitetit dhe mbrojtja e integritetit territorial janë detyra të Qeverisë së Kosovës. Dhe ne si Aleanca e japim mbështetjen e plotë në çfarëdo veprimi që është në këtë funksion. Se a do të kthehet ndonjëherë

ushtria serbe në Kosovë, kjo është një ëndërr të cilën e ëndërrojnë nacionalistët në Serbi. Vuçiqi e di shumë mirë që ushtria serbe nuk do të kthehet kurrë më në Kosovë, dhe sikurse i ka dalë zot Kosovës Ushtria Çlirimtare e Kosovës më 1998/99, do t'i dalë zot Ushtria e Kosovës. Ata guximën e kanë vetëm të provokojnë, ndërsa qeveria jonë të bëjë reagime shtetërore, por jo populiste", ka deklaruar Tahiri.

Ndërkaq lidhur me raportimin për kërcënimin ndaj kryeministrit Kurti, Tahiri ka theksuar se informacionet e hershme, apo paralajmërimi i hershëm ndodh ndërmjet dy institucioneve: institucioneve të inteligjencës së Kosovës dhe vendit mik Maqedonisë së Veriut. Sipas tij, ky komunikim është konfidencial, sekret e jo publik. "Se cili ka qenë nivel i kërcënimit atë nuk e dimë, veç se një shtet siç është Maqedonia e Veriut nuk guxon të bëjë deklaram publik, në qoftë se ekziston një komunikim zyrtar në mes dy institucioneve të inteligjencës të vendeve raport me këtë temë. Nuk mund ta pohoj dhe as ta mohoj sepse nuk kam informacion. As unë nuk jam ndier mirë kur e kam lexuar lajmin se është kërcënuar kryeministri Kurti. Por, më vjen keq dhe nuk ndihem mirë kur një shtet detyrohet të demantojë për një çështje, e cila, siç po shihet, është përdorur për synime politike. Ajo çka ka ndodhur atë ditë, Qeveria e Maqedonisë së Veriut e ka demantuar, ndërsa qeveria jonë nuk është deklaruar", ka thënë Tahiri.

Mitsotakis në Beograd: Nuk kemi ndryshuar qëndrimin karshi Kosovës

PRISHTINË, 12 SHKURT - "Qëndrimi i Greqisë sa i përket Kosovës mbetet i pandryshuar", ka thënë kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis gjatë një vizite në Beograd më 12 shkurt. "Ndërmjetësimi evropian dhe dialogu janë mënyra e vetme për t'i normalizuar raportet mes dy palëve. Kjo do ta ndihmonte ndjeshëm stabilitetin në rajon. Ne po i shikojmë dhe ndjekim me ankth ngjarjet e muajve të fundit", ka theksuar Mitsotakis pas takimit me presidentin serb Aleksandar Vuçiq.

Greqia është në mesin e pesë shteteve të Bashkimit Evropian që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, së bashku me Spanjën, Qipron, Sllovakinë dhe Rumaninë.

Udhëheqësi grek tha se shteti i tij mbështet Serbinë në rrugën e saj evropiane. "Anëtarësimi i Ballkanit Perëndimor në BE është qëllimi ynë strategjik. Është e rëndësishme për Beogradin që të përfitojë nga këto rrethana pozitive në



procedurën evropiane. Duke përsheptuar reformat në shtetin tuaj, ju do t'i afroheni BE-së", shtoi ai. Kryeministri grek, po ashtu, ka

theksuar se ka parë përparim në raportet në mes të Athinës dhe Beogradit. Sipas Mitsotakis, bashkëpunimi në mes të Greqisë dhe Serbisë është zgjeruar në

sektorin e energjisë dhe Athina mbështet projektet infrastrukturore dhe investimet e BE-së në Serbi dhe në Ballkanin Perëndimor. "Ne duhet t'i përdorim

fondet evropiane që janë të dedikuara për Ballkanin Perëndimor", theksoi ai.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka pohuar se "Serbia dhe Greqia gjithmonë kanë mbështetur integritetin territorial të njëra-tjetrës". "Besoj se edhe në të ardhmen do të jetë njëjtë", ka thënë Vuçiqi.

Ai ka theksuar se Serbia "është e vendosur" që ta vazhdojë rrugën evropiane dhe ta falënderojë Greqinë për mbështetjen në këtë drejtim.

Vuçiqi tha se me Mitsotakis ka biseduar për energjinë, përkatësisht për naftësjellësit, gazsjellësit, blerjen e gazit, burimet e energjisë së ripërtërishme, por edhe se si kompanitë greke mund të ndihmojnë që Serbia të ndërtojë këto kapacitete. Ata, po ashtu, kanë biseduar për infrastrukturën dhe transportin, për modernizimin e rrugës dhe hekurudhës nga Beogradi në Selanik dhe lidhjen e Serbisë me portet greke.

POEZI

MEDITIM I
PAJTUESIT
TË GJAQEVE

Muhamet MAVRAJ

/Pesë nismëtarëve të 29 janarit 1990, ish të burgosur politikë,-Myrvetes, Haves, Ademit, Ibrahimit dhe Lulëzimit (Etemaj)/

Plaku te oxhaku
Me ftyrën si hanë e nxime
Nga fjalët
e botës
Durueshëm dëgjoi
zanin
foli e tha:

Kanë ardhë këtu njerëz të mirë në kohë të keqe,
për të marrë faljen
Dhe njerëz të këqinj në kohë të mirë
Tash erdhën njerëz të mirë
si ju, në kohë të mirë si kjo
Prandaj,
në emër të luleve
Falë u qoftë gjaku i tim bir

Sa shpejt harruam

Se kur do të vijnë përsëri
të bëhen bashkë njerëzit
e mirë edhe kohërat e mira

T'ua falë një plagë
Të madhe
Qe kam në zemër

Dhe t'i them shpirtit dil

nëpër
botë
shetit i lirë

(12.02.2024)

Dorëzohet edhe BQK-ja,
shtyn tre muaj
vendimin për dinarin

PRISHTINË, 12 SHKURT - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka bërë me dije se faza e tranzicionit të zbatimit të rregullores së saj, e cila e ndalon përdorimin e dinarit serb, do të zgjasë tre muaj. "BQK në kuadër të veprimeve të saj për zbatim të lehtësuar të efekteve të rregullores për operacione me para të gatshme në komunitete të caktuara, njofton opinionin publik lidhur me planin me veprime shtesë të cilat pritet të realizohen në një afat sa më të shkurtër, por jo më gjatë se tre muaj, në bashkëpunim edhe me bankat dhe institucionet tjera financiare: Funkcionalizimi i linjës së telefonit pa pagesë (0800-222-55), e-mailit për ankesa, si dhe numrit të dedikuar në 'viber'; Lehtësimi i kushteve për hapjen e llogarive bankare, në raste specifike në komunat me shumicë serbe, veçanërisht në katër komunat veriore, me mundësi të kompletimit të dokumenteve (dëshmi të adresës) edhe pas hapjes dhe aktivizimit të llogarisë; Pezullimi i përkohshëm i tarifës të BQK-së e aplikueshme për hapje të degëve/zyrave, për të inkurajuar institucionet

jobankare (me theks për këmbimore) të licencuara për hapjen e zyrave në Komunat e Kosovës me shumicë serbe, veçanërisht në katër komunat veriore; Zgjerimi i prezencës me degë bankare jobankare për mbulimin me degë shtesë dhe rritje të ofrimit të shërbimeve financiare në komunat në veri të vendit", është thënë në komunikatën e BQK-së, duke shtuar se veprim shtesë është edhe organizimi i ofrimit të shërbimeve bankare (hapje e llogarisë) në mënyrë mobile nga bankat komerciale (remote banking) në secilën nga katër komunat veriore, në mënyrë të organizuar me qëllim që të jenë sa më afër qytetarëve, vendosja e disa bankomatëve (ATM) si dhe pajisjeve të tjera për pagesa elektronike (POS), apo vetëshërbime financiare, lehtësimi i procesit të këmbimit të dinarëve me euro nga institucionet financiare dhe këmbimoret e licencuara, vazhdimi i aktivitetit të intensifikuar promovues, me materiale të personalizuar dhe thjeshtëzuara, video-mesazheve, si dhe edukimit financiar të fokusuar, rritja e qasjes në financa, rritja e mëtejshme e

kreditimit dhe pakove të tjera financiare të fokusuara në këto zona nga institucionet financiare dhe rishikimi i kushteve të konvertimit me trajtim preferencial gjatë pranimit të fondeve dhe tërheqjes në bankomate (ATM) me kartela të skemave ndërkombëtare të lëshuara jashtë Kosovës. "Këto veprime ndërmerren krahas angazhimit konstruktiv, në lehtësimin e mekanizmit të transferimit të mjeteve në mënyrë sa më efektive nga Serbia në Kosovë, përmes llogarive bankare dhe modeleve tashmë të njohura, të paraqitur në letrën e propozimit të BQK-së, me gatishmërinë për të shqyrtuar çdo opsion. Ky plan kontribuon veçanërisht tek qytetarët me qasje të kufizuar në financa dhe shërbime financiare dhe mundëson rritjen e qasjes në financa të sigurta përmes bankave dhe institucioneve financiare jobankare, gjithpërfshirjen financiare dhe mbrojtjen e tyre nga aktivitetet financiare të pashëndosha, si angazhime të vazhdueshme të BQK-së mbi bazën e praktikave më të mira evropiane", është theksuar në komunikatën e BQK-së.

Këtë javë dy seanca plenare

PRISHTINË, 12 SHKURT - Kuvendi i Kosovës do të mbledhet në seancë plenare të mërkurën dhe të enjten. Kështu vendosi të hënën Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarë të grupeve parlamentare, të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca. Të mërkurën, më 14 shkurt, në orën 11:00, Kuvendi do ta vazhdojë shqyrtimin e disa pikave të mbetura nga seanca e datës 8 shkurt. Kështu, Kuvendi do të votojë për emërimin tre anëtarëve

vendorë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, pastaj për përzgjedhjen e një kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Komisionarit Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe të një anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e fakulteteve juridike të Republikës së Kosovës. Një ditë më pas, më 15 shkurt, Kuvendi do të mbledhet në

seancë për t'i shqyrtuar tri propozim-amendamentet Kushtetuese, nr. 28, 29 dhe 30, për të vijuar me seancën e radhës, në të cilën do të shqyrtojë në lexim të parë e të dytë një varg projektligjesh, përfshirë ato që ratifikojnë marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe të votojë për themelimin e dy komisioneve hetimore. Kryesia në mbledhjen e së hënës, konform kompetencave të saj, shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e Kuvendit.

221 pjesëtarë të FSK-së u larguan gjatë vitit të kaluar

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije të hënën se 221 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) e kanë braktisur këtë institucion gjatë vitit të kaluar, duke përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë dhe nëpunës civilë. Sipas tij, më shumë se gjysma prej tyre janë larguar për mundësi jashtë FSK-së, duke lëvizur nëpër institucione të tjera. Një ndër arsyet ai ka përmendur edhe shkakun e pagave

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 SHKURT - Gjatë vitit të kaluar 221 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) e kanë braktisur vullnetarisht punën, duke përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë dhe nëpunës civilë. Shifrat i ka bërë me dije ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, gjatë paraqitjes së raportit vjetor të punës për vitin 2023 në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Sipas tij, më shumë se gjysma prej tyre janë larguar për mundësi jashtë FSK-së, duke lëvizur nëpër institucione të tjera. "Sa iu përket daljeve, gjatë vitit 2023 gjithsej janë larguar 221 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë dhe nëpunës civilë. Këtu hyjnë edhe pensionimi i rregullt, që janë 59 pjesëtarë. Pensionim jo i rregullt: dy civilë, pensionim pas arritjes së moshës: 14 pjesëtarë, ndërprerje vullnetare të shërbimit kanë pasur 129 pjesëtarë, ndërprerje vullnetare të shërbimit të rezervës: 4, ndërprerje vullnetare të shërbimit, një civil, shkarkim nga shërbimi ka qenë një, kanë humbur statusin e pjesëtarit të FSK-së 2 pjesëtarë dhe largim nga bordi kemi pasur", ka thënë ministri Maqedonci.

Kryetari i Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, deputeti Bekë Berisha, e ndërpreu ministrin duke i thënë se cilat ishin arsyet e braktisjes. "Ndalemi te këta që e kanë lëshuar, pra që nuk kanë qenë pensionistë", ka thënë Berisha. Ministri Maqedonci ka pohuar se arsyet janë të ndryshme. "Duke filluar nga mirëqenia, pra nga aspekti i pagës, te mundësitë që u ofrohen jashtë institucionit", u përgjigj ministri Maqedonci,



duke thënë se kjo braktisje nuk është trend vetëm te ne në Kosovë. "Është trend global. Të gjitha ushtritë aktualisht janë duke u ballafaquar me mbajtjen e personelit, edhe për faktin që në kuadër të ushtrisë, si oficerët, gjithashtu nënoficerët dhe ushtarët zhvillojnë shkathtësi të veçanta, marrin trajnim të veçantë, i cili shpesh u mundëson atyre të bëhen subjekt 'gjuetie' nga kompanitë e ndryshme jashtë institucionit, duke përfshirë edhe institucionet shtetërore", ka thënë Maqedonci. Ai ka shtuar se lëvizje ka pasur edhe në Policinë e Kosovës prej Forcës së Sigurisë së Kosovës. Para anëtarëve të Komisionit për Siguri, ministri ka bërë me dije se ka pasur ankesa nga pjesëtarët e FSK-së gjatë këtij muaji për çështjen e kompensimit. Megjithatë, ai nuk ka dhënë

detaje se sa është numri i padive, por që pohoi se ka numër të madh të tyre.

Gjatë prezantimit të punës për vitin e kaluar, Maqedonci ka thënë se kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 15 shtete. "Jemi duke marrë pjesë në vazhdimësi në grupin e kontaktit në Ukrainë. Kemi ofruar mbështetje për Ukrainën në disa fusha. Kemi ofruar Qendrën e Kërkim Shpëtim. Kemi mbështetur edhe me transport të ndihmave", ka thënë ai.

Gjatë vitit 2024 Maqedonci shtoi se ka pasur rritje të buxhetit prej 100-përqindësh.

"Gjatë vitit të kaluar është bërë rritja e pagave për Ushtrinë e Kosovës duke vendosur në fokus gradat e ulëta, sepse aty ka qenë edhe nevoja më e madhe për ndërhyrje. Paga e ushtarit nga

422 euro, është rritur në 588, që nënkupton 39 për qind. Tetari i karrierës nga 465 në 609. Është një rritje prej 31-përqindësh dhe tetari nga 489 euro në 609, që është rritje 31 për qind", ka thënë ministri Maqedonci.

Më tej, ai ka njoftuar se janë mbajtur ligjëratat në tetë kazerma të Ushtrisë së Kosovës, ku kanë marrë pjesë 2 100 nxënës në kuadër të Programit Edukativ, Edukimi për Siguri.

Maqedonci, po ashtu edhe për transportin e ushtarëve, duke thënë që është nënshkruar kontrata më 9 janar. "Sigurimi i transportit. Prej datës 9 janar është nënshkruar kontrata për transportin e organizuar, që janë 12 linja. Te uniformat ka qenë një ndër sfidat prej marrjes së detyrës së ministrit të Mbrojtjes. Ne kemi bërë një kontratë emergjente për shkak të nevojës

së furnizimit të ushtarëve me çizme. 120 ditë nga dhjetori është nënshkruar kontrata dhe do të fillojë furnizimi për uniformat", ka thënë Maqedonci.

Ai është deklaruar edhe rreth raportimeve se meritat i takojnë ish-kryeministrit Ramush Haradinaj për sigurimin e sistemit anti-tank amerikan "Javelin" për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Maqedonci në fjalën e tij ka pohuar se kërkesa për këtë sistem ishte bërë në mars të vitit 2022. "Jo, kërkesa për Javelin-et është bërë në mars të 2022-s. Ish-kryeministri Haradinaj ka qenë kryeministri i pari që e adresoi kërkesën për hapjen e programit", ka thënë ai, teksa u pyet nga deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Bekë Berisha.

Trupi gjyqës vendos që mos të ketë kufizime në vizitat private për të akuzuarit në çështjen Thaçi dhe të tjerët



PRISHTINË, 12 SHKURT - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, trupi gjyqës në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ka marrë vendim që të mos vendosë masa kufizuese lidhur me vizitat private të të akuzuarve.

Në vendimin e datës 9 shkurt 2024, kryetari i trupit gjyqës, Charles Smith III, ua ka rikujtuar të akuzuarve, në veçanti Thaçit dhe Selimit, për detyrimin që kanë për të mos iu zbuluar

personave të tretë informacione konfidenciale, raporton "Betimi për Drejtësi". "Për arsyet e lartpërmendura, paneli përmes kësaj ua kujton të akuzuarve, në veçanti zotërinjve Thaçi dhe Selimi, për detyrimin e tyre për të mos u zbuluar palëve të treta të paautorizuara asnjë informacion konfidencial dhe/ose informacion që mund të çojë në identifikimin e dëshmitarëve të mbrojtur; Urdhëron sekretarin që t'u kujtojë vizitorëve në objektet e paraburgimit se ata nuk duhet të

diskutojnë ose të marrin pjesë në diskutimet e informacioneve konfidenciale që kanë të bëjnë me procedurat në KSK me një të paraburgosur, duke përfshirë informacionin që ka të bëjë me identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur", thuhet në vendim.

Veç të tjerash, nëpërmjet këtij vendimi urdhërohen avokatët kryesorë të të gjithë të akuzuarve që t'ua kujtojnë anëtarëve të tyre të ekipit detyrimet që kanë në lidhje me informacionet konfidenciale.

REAGIM I KMDLNJ-së

Pse nuk duhet të votohet traktati për burgje midis Danimarkës dhe Kosovës



Ministria e Drejtësisë thauja në çdo seancë të Kuvendit të Kosovës, si pikë të rendit të ditës e ka votimin e një Traktati midis Danimarkës dhe Kosovës për shitje të një pjese të sovranitetit të Kosovës, burgju i Gjilanit, në një afat 10-vjeçar. Kjo marrëveshje është bërë jashtë syve të publikut, është krejtësisht jotransparente, jashtëzakonisht e dëmshme dhe rrënuese për Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe, në planin afatgjatë rrezikues i situatës së sigurisë në Kosovë. Si e tillë është kundërshtuar nga organizatat për të drejtat e njeriut në Danimarkë kurse në Kosovë përveç KMDLNj - nuk ka kundërshtime serioze për faktin se mungojnë informatat e domosdoshme, ka interpretime qëllimisht të pavërteta nga propozuesi, kushtëzimi klientelist i akterëve që e kuptojnë këtë çështje, SHKK, si më i godituri nga kjo marrëveshje është nënshtruar ndaj një vendimi politik përmes vendosjes së kuadrove të dëgjueshme në poste të caktuara dhe eliminimit të atyre që

eventualisht nuk pajtohen me këtë marrëveshje. Po bëhet një presion mbi deputetët ta votojnë këtë Traktat i cili pas votimit nuk mund të kundërshtohet në Gjykatën Kushtetuese shkaku se konsiderohet si Marrëveshje ndërkombëtare. Në funksion të presionit ndaj deputetëve për ta votuar është edhe vizita e ministrit të Drejtësisë së Danimarkës dhe takimi me grupet parlamentare që paraqet ndërhyrje flagrante në vullnetin e deputetit aq më parë që qeveria e Danimarkës është cilësuar si raciste sa i përket trajtimit të refugjatëve, azilantëve dhe të burgosurve si dhe shkelëse e të drejtave të njeriut. KMDLNj ia përkujton opinionit në Kosovë e sidomos deputetëve të Kuvendit të Kosovës disa fakte të cilat, ose nuk i kanë të njohura, ose janë të shtrembëruara nga propozuesi.

1. Komiteti për Parandalimin e Torturës i Kombeve të Bashkuara në Nju Jork ka kërkuar nga qeveria e Danimarkës ta anulojë marrëveshjen për burgje me Kosovën për faktin se shkelë të drejtat e njeriut.

2. Për vendosjen e refugjatëve,

azilkerkuesve dhe të burgosurve janë përzgjedhur tre shtete, Ruanda në Afrikë, Shqipëria dhe Kosova. Vendet tjera kanë refuzuar këto propozime sidomos vendet e Ballkanit. Për momentin Ruanda është në pikën zero kurse Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje me Italinë. Dihet se çfarë probleme ka pasur Shqipëria me të burgosurit e Guantanamo dhe me iranianët. Këto vende nuk janë zgjedhur si të sigurta sepse kanë situatë të paqëndrueshme por se iu janë imponuar këto marrëveshje.

3. Nuk është e vërtetë se në Kosovë do të transferohen të burgosurit danezë siç po manipulon propozuesi. Asnjë i burgosur nuk është danezë, të gjithë janë të vendeve të treta nga Afrika dhe shtetet arabe, kryesisht.

4. Opinioni nuk po informohet fare as për lartësinë e dënimeve e as për natyrën e veprave të të burgosurve që do të transferohen në Kosovë. Janë të pavërteta pohimet se të burgosurit që do të transferohen nuk janë të rrezikshëmërisë së lartë. Po të ishin

të një rrezikshmërie të ulët pse do të transferohen në Kosovë?! Danimarka do të lirohet nga ta pikërisht se nuk duan të resocializohen.

5. Nuk është i saktë fakti se Kosova është përzgjedhur shkaku se i trajton mirë të burgosurit për faktin se këta do të trajtohen sipas ligjeve të Danimarkës e jo të Kosovës. Kosova vetëm ofron fuqi punëtore si në baustellë, oficerët korrektues të Kosovës i nënshtrohen guvernatorit danez që, me ekip e udhëheq këtë burg.

6. Është rast i pashembullt që brenda një shteti legalizohen dy sisteme paralele për sanksionim të veprave penale, ai i Kosovës dhe ai i Danimarkës.

7. Me ardhjen e këtyre të burgosurve të paftuar në Kosovë do të rritet krimi i organizuar, tregtia me narkotikë, radikalizmi islamike, trafikimi me qenie njerëzore dhe prostitucioni.

8. Të burgosurve "danezë" do iu shkelen të drejtat e njeriut si vizitat familjare, kujdesi shëndetësorë në rast se duhet të trajtohen jashtë institucionit, shfrytëzimi i beneficioneve mbrojtja ligjore, komunikimi dhe

informimi në gjuhën amtare etj.

9. Statusi material po e përcakton trajtimin e të burgosurve, "danezët" do ta vuajnë dënimin në burgjet kurse të burgosurit kosovarë përkundër që janë shumë social, as në ëndërr nuk do i kenë ato të drejta.

10. Është e pabesueshme se si Komisioni përkatës i Kuvendit të Kosovës ka votuar për këtë marrëveshje, ose nuk kanë pasur informata të sakta për këtë, ose nuk marrin vesh fare për këtë çështje.

11. Me këtë marrëveshje po shpërfilllet dhe dhunohet një punë aq e mirë dhe aq e madhe e Shërbimit Korrektues të Kosovës hiç këtu servilëve të pushtetit.

12. Pablo Eskobari, në marrëveshje me qeverinë e Kolumbisë e pati ndërtuar një burg personal ku të drejtat që i takojnë nuk i ka bërë sipas ligjeve të Kolumbisë por në saje të investimeve materiale që i ka bërë personalisht. A po e bëjnë pikërisht këtë pabloeskobarët e Kosovës me pabloeskobarët e Danimarkës me Traktatin për burgje? Nëse do të votohet, pa asnjë dyshim se po.

Dhjetë të lënduar nga zjarri në një ndërtesë kolektive në Ferizaj

FERIZAJ, 12 SHKURT - Dhjetë persona janë lënduar pas shpërthimit të një zjarri në një ndërtesë kolektive në Ferizaj në orët e vona të 11 shkurtit. Sipas Policisë së Kosovës, nëntë persona kanë pësuar lëndime

trupore dhe një zjarrfikës, të cilët janë dërguar për trajtim mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Autoritetet thanë se, pos të lënduarve, ka edhe dëme materiale. Policia tha se ende nuk

dihen shkaqet e shpërthimit të zjarrit, përderisa shtoi se me të marrë informacionin për shpërthimin e zjarrit, në vendin e ngjarjes dolën njësitë e zjarrfikësve, njësitë policore dhe ato emergjente.




Javën e kaluar në rajonin e Prishtinës janë realizuar 284 urdhëresa të gjykatës

PRISHTINË, 12 SHKURT - Nga zyrtarët policorë të rajonit Prishtinës, gjatë javës së kaluar, në lokacione të ndryshme e aksione të ndara, janë realizuar 284 urdhëresa të gjykatës, prej tyre 41 urdhëresa për vepra penale, ndërsa të tjerat për kundërvajtje, seanca, verifikime etj. Konform urdhëresave, pas

përfundimit të procedurave policore, personat e dënuar me burgim janë dërguar për vuajtje të dënimit, ndërsa personat e dënuar me gjobë janë liruar, pasi i kanë kryer obligimet e caktuara në urdhëresa.

Aktivitetet policore janë shtrirë edhe në segmente të tjera të sigurisë. "Kësisoj në harkun e njëjtë kohor janë

sekustruar dy armë zjarri. Ndërkaq aktivitetet policore në sferën e sigurisë në trafikun rrugor, në po të njëjtën periudhë kohore, kanë rezultuar me shqiptimin e 3 854 masave administrative me gjobë për lloje të ndryshme të kundërvajtjeve dhe shkeljeve të kodit rrugor", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Serbët në Mitrovicë të Veriut protestojnë kundër ndalimit të dinarit

PRISHTINË, 12 SHKURT - Në Mitrovicë të Veriut serbët protestuan të hënën kundër vendimit të autoriteteve të Kosovës që vetëm euroja të jetë valuta për pagesa, duke përjashtuar dinarin serb.

Në fillim të protestës organizatorët thanë se përmes saj po ngrihet "zëri kundër padrejtësisë dhe përndjekjes së Prishtinës për ta hequr dinarin e fituar me mund". Rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës për pagesat vetëm me euro ka hyrë në fuqi më 1 shkurt përkundër kundërshtive nga serbët lokalë dhe faktori ndërkombëtar.

Protesta, që u përkrash nga Sindikata e Punëtorëve Serbë që punojnë në sistemin paralel të Serbisë në Kosovë, u mbajt pranë urës kryesore mbi lumin Ibër.

Pjesëmarrësit në protestë ishin nga të gjitha komunat ku jetojnë pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë.

Tek ura mbi Ibër ishin të pranishëm pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë,

KFOR.

Në protestë morën pjesë edhe përfaqësues të Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. "Vendimi për ta hequr dinarin, për të na pamundësuar tërheqjen e pensioneve të merituar, do të thotë se po merret buka e gojës, po na ndërpritet jeta", tha në emër të pensionistëve, Dushanka Qoroviq.

Ajo shtoi se është gënjeshtër që serbët mund të hapin llogari në bankat në Kosovë sepse, sipas saj, ato "nuk pranojnë fondin pensional serb".

Qeveria e Kosovës ka thënë se serbët do të mund të hapin llogari, pa pagesë, ku mund t'i bartin paratë e tyre në dinarë, të cilat më pas do të konvertohen në euro për të kryer pagesa. "Duhet të anulohet ky vendim dhe të mundësohet dërgimi i dinarëve në postat tona, në bankat tona", tha Dushanka Qoroviq.

Në emër të punëtorëve shëndetësorë foli Dragisha Milloviq nga Qendra Spitalore Klinike,



përndryshe nënkryetar i Listës Serbe. "Ky vendim drejtpërdrejt shënjestron popullin tonë serb dhe kërcënon mbijetesën dhe qëndrimin e tyre nëse mbetet në fuqi. Ky vendim ka për qëllim zhbërjen e institucioneve serbe në këto zona", tha Milloviq. Milloviq i ftoi përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe ambasadorët e shteteve të Quint-it ta ndalojnë vendimin e BQK-së dhe ai të

shfuqizohet, duke shtuar se "[kryeministri i Kosovës, Albin] Kurti nuk ka të drejtë ta ndalojë dinarin".

Në emër të punëtorëve të arsimit, Vesna Martinoviq, që udhëheq shkollën fillore në Uglarë, kërkoi që "të mos mohohet e drejta për të fituar", duke theksuar se vendimi i Prishtinës nënkupton se do t'u vihet "çelësi të gjitha shkollave serbe".

Sipas BQK-së, për të hapur një llogari në ndonjë prej bankave në Kosovë nevojiten disa dokumente dhe më kryesoret janë: një dokument identifikues [letërnjoftim apo pasaportë], një faturë komunale jo më e vjetër se tre muaj dhe një dëshmi mbi adresën ku jetoni, që mund të jetë certifikata e vendbanimit apo një faturë komunale në të cilën gjendet edhe adresa.

Dita Ndërkombëtare e Epilepsisë, mbahet simpozium për sëmundjen e epilepsisë



PRISHTINË, 12 SHKURT - Përmes Simpoziumit "Epilepsia dhe shtatzënia" është shënuar Dita Ndërkombëtare e Epilepsisë, me organizim të Shoqatës Kundër Epilepsisë së Kosovës e me mbështetjen e Shoqatës së Neurologjisë së Kosovës.

Hapjen e këtij simpoziumi e bëri profesor Afrim Blyta, kryetar i Shoqatës së Neurologëve, i cili, me këtë rast, tha se puna e mjekëve dhe profesionistëve

shëndetësorë është një tregim që nuk përfundon, kurse esenca e organizimit të simpoziumeve të tilla është që të diskutohen arritjet e mëtutjeshme profesionale për profesionistët shëndetësorë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, tha se takimet e tilla janë të mirëpritura ngase profesionistët e fushës kanë mundësinë të diskutojnë

dhe shkëmbejnë përvojat e tyre nga fusha e neurologjisë, në këtë rast për sëmundjen e epilepsisë. Kryetarja e Shoqatës Kundër Epilepsisë, prof. Valbona Govori, theksoi se këtë vit si temë bosht të diskutimeve kanë zgjedhur "Epilepsinë dhe shtatzëninë". Në diskutimet e tyre neurologë dhe profesionistë të tjerë mjekësorë diskutuan për rastet e epilepsisë të shtatzënat dhe menaxhimin e sëmundjes.

ShSKUK-ja ngushëllon familjen me rastin e vdekjes së dr. Halil Tanaj

PRISHTINË, 12 SHKURT - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka theksuar se me dhimbje dhe pikëllim të thellë ka pranuar lajmin për vdekjen e mjekut të përkushtuar e të shquar, dr. Halil Tanaj.

"ShSKUK ngushëllon familjen, miqtë dhe kolegët me rastin e

vdekjes së dr. Tanaj. Dr. Halili ishte profesionist i shquar, njeri human dhe e përkushtuar për ofrim të shërbimeve shëndetësore. Ai deri në momentet e fundit ishte përkrah pacientëve, ndaj të cilëve ishte shumë i përkushtuar. Familja humbi njeriun më të dashur, kurse

ShSKUK-ja një profesionist me virtyte të larta njerëzore dhe profesionale dr. Halili, do të mbetet çdoherë në mendjet tona, si njeri dhe profesionist i përkushtuar, shembull që do të shërbejë për gjenerata të tëra, edhe pse fizikisht u nda nga ne!", është thënë në njoftimin e ShSKUK-së.



KEDS-i investoi mbi 400 mijë euro në Drenicë

PRISHTINË, 12 SHKURT - Një rrjet energjetik komplet i ri tashmë shtrihet në fshatrat Gradicë, Likoshan, Gllanasellë dhe Godancë të komunës së Drenasit. KEDS-i ka investuar në tensionin e ulët dhe atë të mesëm në linjat ajrore dhe kabllore në një terren me shtrirje mjaft të gjerë në këto anë.

Këtu KEDS-i ka vendosur 5 transformatorë të rinj, mbi 400 shtylla të betonit dhe mijëra metra kabllor elektrike.

Kostoja e gjithë këtij projekti llogaritet mbi 400 mijë euro. Banorët dhe bizneset e këtyre anëve tanimë nuk do të kenë telashe nga erërat dhe faktorët e tjerë atmosferikë, të cilët më herët shkaktonin telashtet. Projekti i ri siguron shërbime më të sigurta dhe më kualitative. Nga investimet e KEDS-it mjaft të kënaqur janë shprehur edhe konsumatorët përfitues nga ky investim.

Për banorët e kësaj ane

përfitimet janë të mëdha dhe ndryshimet janë si nata me ditë, thotë kryetari i fshatrave Likoshan dhe Gradicë, Hafiz Muja. "Investimet e KEDS-it, përveç që do të na sjellin stabilitet energjetik, do të na sjellin edhe ndriçimin publik që kurrë nuk e kemi pasur. Rrjeti ka qenë i viteve '70 dhe gjithnjë me probleme. Sot jemi shumë të kënaqur me punën e KEDS-it", shton Muja.

KEDS-i po vazhdon



investimet në shumë vendbanime të Kosovës për ta modernizuar rrjetin elektrik, që është një zotim i

kompanisë për t'i zgjidhur problemet infrastrukturore në distribuimin e energjisë elektrike.

Kurti: Nuk mund ta zhbëjmë vendimin për dinarin serb

PRISHTINË, 12 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se nuk do të hiqet dorë nga vendimi që vetëm euroja të jetë valuta për pagesa në Kosovë, por tha se po respekton kërkesat e faktorit ndërkombëtar për këtë çështje.

Që nga 1 shkurti në Kosovë ka hyrë në fuqi një rregullore e Bankës Qendrore të Kosovës, e cila përjashtoi valutat e tjera, përfshirë dinarin serb për pagesa. Gjatë një interviste për Bloomberg, Kurti përsëriti se me rregulloren e BQK-së për operacione me para të gatshme nuk ndalohet mbajtja e dinarëve serbë, pasi kjo valutë mund të përdoret për pagesa vetëm pasi të konvertohet në euro në një nga bankat e licencuara në Kosovë. "Nuk mund ta zhbëjmë këtë vendim. Pra, ata kërkuan për më shumë kohë dhe ne po u japim më shumë kohë. Tani edhe partnerët tanë amerikanë dhe

evropianë po thonë se rregullorja është ligjore sepse po lufton financimin e terrorizmit, aktivitetet e paligjshme, por ne nuk duhet të ngutemi shumë në zbatimin e plotë. Dhe kështu do të veprojmë gjatë shkurtit", tha Kurti.

Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

Rregullorja është kritikuar nga faktori ndërkombëtar, që ka argumentuar se vendimi është marrë pa konsultime paraprake. Ndërkombëtarët i kanë kërkuar Kosovës që ta shtyjë zbatimin e rregullores, duke thënë se duhet më shumë kohë për adaptimin e komunitetit serb me vendimin.

Qeveria e Kosovës ka thënë se përgjatë shkurtit do të ketë fushata për informimin e serbëve për këtë vendim dhe në këtë



kuadër, Kurti më 11 shkurt iu adresua qytetarëve serbë, në gjuhën serbe, duke thënë se vendimi nuk e ndalon Serbinë që të vazhdojë t'i ndihmojë serbët në Kosovë.

Gjatë intervistës në Bloomberg, Kurti u pyet se cili është qëllimi i tij final për serbët në veri të Kosovës, ku ata përbëjnë shumicën e popullsisë. Kurti tha se ai dëshiron që ata të

integrohen në shoqëri, duke theksuar se shumica e tyre veçse e kanë bërë këtë përmes pajisjes me letërnjoftime dhe pasaporta të Kosovës. "Problemi nuk janë serbët e Kosovës. Problemi është regjimi autokratik në Beograd, që është bashkëpunëtor rus. Është regjim që varet nga Kremli. Ata janë duke e bërë këtë alarmimin para-apokaliptik, duke nxitur tensione etnike sepse ata duan të shkaktojnë probleme në rajon", tha Kurti.

Në një seancë të jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 8 shkurt, ku u diskutua për situatën në Kosovë pas vendimit për ndalimin e dinarit, Serbia dhe Rusia thanë se me këto veprime Kosova po kryen "spastrim etnik" ndaj serbëve në Kosovë.

Kurti iu përgjigj këtyre akuzave, duke i cilësuar gënjeshtër.

ATK-ja: Janari me 4.26 milionë euro të hyra më shumë se plani



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 SHKURT - Si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme për t'i mbledhur tatimet në përputhje me ligjin, Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar rezultatet e të hyrave të mbledhura për muajin e parë të vitit 2024.

Në muajin e parë të vitit 2024, ATK-ja ka arritur të mbledhë një shumë të konsiderueshme të të hyrave tatimore. Shuma prej 111.22 milionë eurosh e të hyrave të

mbledhura ka tejkaluar pritshmëritë e ATK-së, duke arritur të mbledhen 14.5 milionë euro më tepër se periudha e njëjtë e vitit të kaluar, si dhe 4.26 milionë euro apo 4% më tepër se plani.

Këto rezultate janë tregues i përpjekjeve të vazhdueshme për ta forcuar zbatimin e ligjit dhe për ta siguruar integritetin, besueshmërinë dhe profesionalizmin në mbledhjen e tatimeve.

Ky sukses reflekton punën e palodhshme të punonjësve të ATK-së si dhe bashkëpunimin e mirë me

institucionet e rendit dhe ligjit, por edhe me tatimpaguesit. ATK-ja ka njoftuar se është e përkushtuar për sigurimin e një mjedisi të drejtë dhe transparent për të gjithë tatimpaguesit.

Administrata Tatimore e Kosovës i ka falënderuar të gjithë tatimpaguesit për bashkëpunimin e tyre si dhe i inkurajon ata të vazhdojnë të deklarojnë dhe t'i paguajnë tatimet e tyre në përputhje me ligjin për të kontribuar në zhvillimin e vendit tonë.

Kosova dhe Shqipëria diskutojnë për bashkëpunimin në fushën e biznesit

PRISHTINË, 12 SHKURT - Zëvendësministri për Evropë dhe Punë të Jashtme i Shqipërisë, Besart Kadia, së bashku me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, ka vizituar Odën Ekonomike të Kosovës. Ai është pritur nga kryetari i saj, Lulzim Rafuna.

Të pranishëm në këtë takim

ishin edhe zëvendësministrija e Punëve të Jashtme të Kosovës, Liza Gashi dhe bizneset anëtare të OEK-ut.


Në kuadër të këtij takimi u diskutua rreth sfidave që i kanë gjetur procesit të të bërit biznes me shtetin e Shqipërisë dhe mundësitë e bashkëpunimit në fushën e biznesit.

Ambasadori i Shqipërisë në

Kosovë, Petrit Malaj, ka thënë se Kosova do të jetë një partnere e fuqishme për Shqipërinë. "Kosova do të jetë një partnere e fuqishme për Shqipërinë. Ne e dimë se kemi çfarë të bëjmë, janë bërë gjëra të mira, por këto diskutime janë për t'i bërë akoma më mira", ka thënë ambasadori Malaj.



Lord Bajroni - i çmendur apo hero, i shthurur apo vetmitar?



Nga: Camille RALPHS
Përkthimi (i pjesshëm)
nga: *Telegrafi.com*

Lord Bajroni (1788-1824) është një ndër eksportet më të mëdha të Mbretërisë së Bashkuar. Atëherë, pse kaq shumë njerëz e trajtojnë me kujdes dhe me turp? Ndoshta e gjykojmë për pasionet e tij tronditëse (jo më pak me Augustën, me gjysmë motrën e tij, dhe me shumë gra dhe burra të botës) – ose i urrejmë sjelljet e tij. Ndoshta fjala është për punën e tij: mijëra faqe me rima të ethshme e ndonjëherë fëmijërore. Ose, ndoshta kemi frikë se ai – siç deklaroi dikur [William] Wordsworth – ishte “i çmendur”. Në Greqi, në ndërkohë, ai është hero kombëtar: vdiq në moshën 36-vjeçare – 200 vjet para kësaj pranvere – në Mesollonjë gjatë Luftës së Pavarësisë Greke, në të cilën ai i drejtoi fushatat dhe dha mbështetje materiale. Biografite e shumicës së poetëve janë ose të pashkruara ose të palexueshme, por Bajroni ka dhjetëra – që të gjithat interesante. Çdo kronikan i

Bajronit, që nga Thomas Moore (1830), ka pasur informata për kujtimet vulgare të poetit. Ato u dogjën. Por, Moore i përdori për shkrimin e tij dhe ne e dimë se ato shënuan takimin e pafat të Bajronit me Annabella Milbankein dhe vitet e tij të kënaqësisë luksoze në Venecia më 1816-19. (Letrat sugjerojnë se të paktën 200 gra ishin në shtratin e tij në atë kohë, disa ishin motra, shumica të paguara.) Dhe, e dimë se çfarë nuk kishte te to: transformimi përfundimtar i Bajronit në një ushtarak relativisht të vetmuar. Letrat për të dhe nga ai e tregojnë mirë ndryshimin e tij thelbësor. Është e vlefshme biografia e re e Andrew Staufferit, Bajroni: Një jetë me dhjetë shkronja e cila çdo kapitull e fillon me një shkronjë nga pena e poetit (dhe citon me empati edhe letrat e grave). Është shtesë e biografive, por struktura e tij e mozaikut ngathët merret me evolucionet e Bajronit.

Një nga argumentet e Staufferit është se kontesha Teresa Guiccioli ishte dashuria më e madhe e Bajronit. Kjo mund të

thuhet, ndonëse është e diskutueshme – John Hobhouse shkroi se partneriteti nuk ishte i mirë, se “[Bajroni] ma tha krejt të kundërtën”. Teksa Teresa ishte e dashura e tij më e pabraktisur, me gjasë e fundit, arsyeja e Fiona MacCarthyt ka mbetur bindëse: “Bajroni lulëzoi në vështirësi”, duke mbajtur gjithmonë një mur mes vetes dhe atyre që pretendonte se i donte. Për shkak se Teresa ishte e martuar, Bajroni nuk mund të ndihej i bllokuar prej saj. Letra më e singërtë e dashurisë që ai shkroi ndonjëherë ishte për të, në anglisht. Por, ai nuk pranoi t’ia përkthente dhe e la edhe atë, më në fund, kur ra në dashuri me Greqinë.

Stauffer gjithashtu thekson personalitetin e “aktorit të metodës” të Bajronit. Stauffer shpesh e paraqet atë “duke bërë dhe duke thënë gjëra në sasi të mëdha [në mënyrë] që të mund të shkruajë për to”: teksta shkruan një letër, Bajroni joshte gruan e dikujt në një festë – para të gjitha palëve të pranishme. Personazhet që i dhanë formë imazhit të tij për përfshijnë [dramën] Kaini (Bajroni besonte


se ishte i shënjuar, nga trashëgimia, si shëtitës dhe i mallkuar), Adami i Miltonit (Bajroni thotë se “bota është e gjitha para tij”, ndërsa e dëbon veten nga një paradajse pas tjetrës) dhe Paolo dhe Françeska e Dantes të cilët janë goditur në rrethin e dytë të Ferrit nga erërat e kundërta të epshit të tyre dhe që e nisën lidhjen e tyre të dashurisë përmes letërsisë.

Ndikimet e tij letrare ndikuan në jetën e tij. Çështja e paraqitjes së jetës së tij në veprën e tij është më komplekse. Siç shkroi Martin Amis te Jeta e Kolerixhit, shpeshherë shkrimtarët “e ngrenë levën [e subjektit] në një levë biografike”. E aplikuar në shumicën e veprave, kjo qasje është e çuditshme: korrelacioni nuk do të thotë shkak, siç e dinë të gjithë statisticienët e rinj. Me Bajronin nuk është aq e diskutueshme. Kantoja e dytë e Don Zhuanit – në të cilin heroi i tij i mbijeton një mbyetjeje të anijes – ishte, pohoi ai, tërësisht i nxjerrë nga fakti. Në një letër të vitit 1814, ai e quan poezinë “pasqyrim të botës”; në ditarin e tij më 1821, është “ndjenja e një bote dhe të ardhmeje të

dikurshme”. Është më e sigurt të thuhet, sipas kritikut Jerome McGann, se “gjysma e percepton dhe gjysmën e krijon” ekzistencën e Bajronit.

Në të vërtetë, sapo pushoi së shkruari, shpirtat e reflektimit dhe të veprimt u hoqën prej tij – qëkur mjekët u përpoqën të kuronin malarin përmes gjakderdhjes, më 1824. Veprat e mprehta dhe të Bajronit meritojnë një jetë të përtejme më madhështore; por, nëse kjo nuk mund të gjendet, ai ecën dhe megjithatë hedh magjepsjen e tij mes nesh. Miku dhe doktori i Bajronit, John Polidori ishte me të dhe çiftin Shelley në Villa Diodati më 1816, kur lindi Frankeshtajni, dhe e bazoi Vampirin (1819) në disa faqe ku Bajroni shkroi për një burrë që vdes në Greqi, por ringjallet nga të vdekurit nga synimet e dashurisë. Sipas librit të Staufferit, “çdo vampir aristokratik i rrezikshëm tërheqës, nga Drakula e Bram Stokerit e deri te Lestati nga Anne Rice, mund të gjurmohet te Bajroni”. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Gjoni Palokaj fiton përballjen ndaj çekut Jaroslav Pokory



“Epoka e re”

OBERHAUSEN, 12 SHKURT - Sportisti shqiptar me prejardhje nga Prizreni, Gjoni Palokaj, ka shënuar fitore të rëndësishme në karrierë. Palokaj ka nënshkruar kontratë me Oktagon, e cila është një organizatë e Çekisë dhe më e madhja në Evropë. Palokaj

ka shënuar fitore në artet e përziera parçiale ndaj Jaroslav Pokory në përballjen e zhvilluar në Oberhausen të Gjermanisë. Mbi 12 mijë shikues kanë qenë në “Rudolf Weber Arena”. Kundërshtari i Gjonit është numër pesë në “Featherweight”, derisa e ka fituar me pikë. “Jam shumë i lumtur dhe krenar që kam mbështetjen e të gjithë

shqiptarëve nga mbarë bota”, ka thënë Plaokaj pas fitores. 28-vjeçari i rritur në Gjermani trajnohet në shkollën “Fightschool” në Hannover, e cila është ndër më të mëdhatë në këtë qytet të madh të Gjermanisë. Kjo shkollë është e axhës së sportistit në fjalë, David Palokaj, i cili është edhe trajner i Gjonit.

Sot fillon festa e basketbollit në Gjakovë

Palestra “Shani Nushi” do të jetë arenë e basketbollit nga 13 deri më 17 shkurt.

Tetë skuadra të elitës janë në kërkim për trofeun e çmuar të Kupës së Kosovës.

Më 17 shkurt zhvillohet edhe finalja e femrave në mes të Bashkimit e Prishtinës, dy skuadrave për momentin më të mirat në basketbollin e femrave në vendin tonë. Katër skuadrat e Ligës së Parë të Meshkujve e rritin edhe më shumë rëndësinë e kësaj ngjarje në Gjakovë. Basketboll cilësor pritet në parket dhe atmosferë e jashtëzakonshme në tribuna me pjesëmarrjen e tifozëve nga e gjithë Kosova.

Gjakova ka qenë shembull për organizim dhe kështu pritet edhe në Final 8.

Të martën dhe të mërkurën zhvillohen sfidat çerekfinale, ndërsa të enjten gjysmëfinalet. E premija është pushim për t'u përgatitur për finalen e madhe të shtunën. Basketboll dhe jo vetëm, do të ketë në Gjakovë nga 13 deri më 17 shkurt. Pikërisht finalët zhvillohen më 17 shkurt, në festën e Pavarësisë së Kosovës. Trepça triumfoi në dy vitet e fundit, derisa rivaliteti i madh pritet këtë edicion.

Të gjitha ndeshjet do të transmetohen ekskluzivisht në “Art Motion” dhe “Kujtesa”.



ORARI

Më 13 shkurt takohen:
14:00 Bora - Kosovari
17:00 Trepça - Istogu
20:00 Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi

Më 14 shkurt takohen:
14:00 Vushtrria - New Basket
17:00 Peja - Bashkimi
20:00 Sigal Prishtina - Proton C. Prizreni

Më 15 shkurt takohen:
14:00 Finalja - Liga e Parë
17:00 Gjysmëfinalja I
20:00 Gjysmëfinalja II

Më 17 shkurt takohen:
14:00 Finalja: KBF Prishtina - KBF Bashkimi
17:00 Finalja: Kupa e Kosovës

Copes i Bashkimit, MVP i javës në Superligën e basketbollit



Prizren, 12 shkurt - Bashkimi mundi rivalen e vjetër të basketbollit, Pejën, në sfidën që u zhvillua në Prizren, derisa basketbollisti më i dalluar ishte Erik Copes.

Qendra e mbylli ndeshjen me 24 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime, si dhe kishte dy bllokada e një top të vjedhur. Copes kishte indeksin 35, apo më të lartin e kësaj xhiro, duke u shpallur MVP, që nuk është hera e parë për të. Në një sfidë me kthesa Trepça mundi Golden Eagle Yllin, për ta vazhduar

serinë pozitive. Te mitrovicasit u dallua Jordy Tshimanga me 18 pikë e 19 kërcime. Ai u ndihmua nga Darnell Edge me 16 pikë, pesë kërcime e pesë asistime. Me rikthim fitoi edhe Sigal Prishtina ndaj Vëllaznimit, kurse te bardhekaltrit më i miri ishte Donte Clark me 16 pikë, tetë kërcime dhe tri asistime. Fitore shumë të rëndësishme shënoi Proton Cable Prizreni ndaj Istogut, ku te prizrenasit më i miri ishte Ty Cockfield me 18 pikë, tetë kërcime dhe dy asistime.

MVP

Erik Copes (Bashkimi) 24 pikë, 9 kërcime, 3 asistime, 35 indeksi

Top pesëshja

Erik Copes (Bashkimi) 24 pikë, 9 kërcime, 3 asistime, 35 indeksi
Jordy Tshimanga (Trepça) 18 pikë, 19 kërcime, / asistime, 31 indeksi
Donte Clark (Sigal Prishtina) 16 pikë, 8 kërcime, 3 asistime, 22 indeksi
Ty Cockfield (Proton Cable Prizreni) 18 pikë, tetë kërcime, 2 asistime, 22 indeksi

Darnell Edge (Trepça) 16 pikë, 5 kërcime, 5 asistime, 17 indeksi

Diar Vokri, ‘Ylli i javës’ në Superligë

Prishtinë, 12 shkurt - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e 19, të parën në stinorin pranveror, në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të KF Llapi, Diar Vokri. Vlerësimi i më të mirit të javës

është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit, në përbërje: Sunaj Keqi, Berat Berisha dhe Xhavit Mehmeti. Ky komision vendosi për mbrojtësin llapjan, pasi ai gjatë gjithë ndeshjes Drita - Llapi pati paraqitje të shkëlqyeshme në fazën defensive, derisa ishte edhe asistent në golin e fitores.

Çmimin “Ylli i javës” për futbollistin e KF Llapi, Diar Vokri e ndau Edon Sejday, dizajner në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim mbrojtësi llapjan u shpreh i lumtur për vlerësimin dhe fitoren e skuadrës së tij në derbi. “Është një ndjenjë shumë e mirë dhe jam shumë i lumtur për çmimin ‘Ylli i Javës’.

Është hera e parë që e fitoj këtë çmim dhe kjo më jep motiv shtesë për të punuar edhe më shumë në të ardhmen. Fitorja kundër Dritës na shtyn para drejt synimeve tona në këtë edicion, pasi e dimë që Llapi këtë edicion është pretendent për titull dhe shpresojmë që në fund ta festojmë. Falënderoj



bashkëlojtarët dhe klubin, ngase pa mbështetjen e tyre nuk do të isha sot këtu”, ka thënë Diar Vokri për faqen zyrtare të FFK-së.

Kryetari i FFK-së priti në takim presidentin e Rotherham United, Tony Stewart

PRISHTINË, 12 SHKURT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur në takim presidentin e Rotherham United, Tony Stewart. Në skenën e futbollit britanik, emri i Tony Stewart është një prej historive më të suksesshme dhe frymëzuese. Si drejtor i

Rotherham Unitedit ai ka ndërtuar jo vetëm një ekip të suksesshëm, por edhe një atmosferë të padiskutueshme të lojalitetit dhe pasionit të tifozët. Stadiumi i Rotherham Unitedit, i njohur si AESSEAL New York Stadium, është shfaqja më e shquar e vizionit dhe

përkushtimit të Tony Stewart për klubin dhe komunitetin lokal. Kjo arenë moderne, e hapur në vitin 2012, është një ndërtesë e rrallë që përfaqëson standardet më të larta të futbollit britanik. Tony Stewart përgëzoi kreun e FFK-së për punën e mirë që po bën. Po ashtu, ata diskutuan

edhe për mundësi të bashkëpunimeve në të ardhmen e afërt. Në fund të takimit, kryetari Ademi e nderoi mysafirin me fanellën e personalizuar të Kosovës dhe me simbolin e kryeqytetit - "Hyjneshën në fron".



Humb jetën në një aksident tragjik Kelvin Kiptum

NAIROBI, 12 SHKURT - Rekordmeni botëror i maratonës për meshkuj, Kelvin Kiptum nga Kenia, ka humbur jetën në një aksident tragjik në vendin e tij. 24-vjeçari vdiq së bashku me trajnerin e tij Gervais Hakizimana nga Ruanda, pasi humbi kontrollin e automjetit gjatë vozitjes në Kaptagat, në orën 23:00 me kohën lokale.

Presidenti i Atletikës Botërore, Sebastian Coe, shkroi në X: "Jemi të tronditur dhe thellësisht të pikëlluar kur mësuam për humbjen e Kelvin Kiptum dhe trajnerit të tij, Gervais Hakizimana. Në emër të të gjithë Atletikës Botërore ne u dërgojmë ngushëllimet tona familjeve, miqve, shokëve të skuadrës dhe kombit kenian". "Ishte vetëm në fillim të kësaj jave në Çikago, vendi ku Kelvin vendosi rekordin e tij të jashtëzakonshëm botëror në maratonë, që unë munda ta ratifikojta zyrtarisht kohën e tij historike. Një atlet i jashtëzakonshëm që lë një trashëgimi të pabesueshme, do të na mungojë shumë".



Rekordi botëror i Kiptum në maratonën 2:00:35, i vendosur në Maratonën e Çikagos në tetor të vitit të kaluar, u ratifikua vetëm disa ditë më parë nga World Athletics. 24-vjeçari kishte kaluar vetëm në vrapimin e maratonës nga garat me

distanca më të shkurtra një vit përpara se të vendoste atë ritëm rekord. Ai, gjithashtu, kishte njoftuar së fundmi planet për t'u bërë atleti i parë që do të vrapojë një maratonë zyrtare në më pak se dy orë, në Roterdam, në prill.

Bostoni vazhdon kryesimin në Lindje, Oklahoma surprizë në Perëndim

BOSTON, 12 JANAR - Janë luajtur vetëm dy ndeshje së fundmi në NBA dhe në parket zbritën skuadrat kryesuese në të dyja konferencat. Në Lindje, skuadra e Bostonit fitoi 110-106 ndaj Miami Heat dhe konsolidon kreun e renditjes, duke marrë fitoren e 41-të sezonale. Një përballje mes dy ekipesh pretendente për titullin, ku të dyja e kërkuan fitoren. Tatum me 26 pikë e Porzingis me 25 pikë ishin dy më të mirët për Bostonin, ndërsa 24 pikët e Herros për Miamin mbetën për statistikë. Bostoni është ekipi i vetëm në NBA që ka arritur kuotën e 40 fitoreve këtë sezon deri më tani. Në Perëndim vijon paraqitja e mirë e Oklahoma City Thunderit, që mposhti 127-113 Sacramento Kingsin, sukses që e



ngjit në vendin e tretë në Perëndim. Alexander Shai me 38 pikë si dhe Jalen Williams me 32 pikë bënë diferencën në fushë për Oklahomën, e cila është quajtur

surpriza e këtij sezoni në NBA, duke lënë pas vetes ekipe pretendente, përfshirë kampionët në fuqi të Denver Nuggetsit.

SHKURT

Xavi pas barazimit ndaj Granadës: Laporta tha se kjo është e tepruar

Skuadra e Barcelonës ka barazuar me rezultat 3-3 ndaj Granadës. Trajneri Xavi Hernandez ka thënë se, pavarësisht këtij gabimi, skuadra e tij nuk do të dorëzohet në garën për titull në La Liga. "Është e vështirë. Sot edhe më e vështirë. Diferenca është e madhe, por jo e pamundur. Nuk do të dorëzohemi. Skuadra ka pasur besim, guxim, dëshirë... por është e pamjaftueshme. Është turp sepse ishte një mundësi e mirë për të qëndruar në garë, por po bëhet më e vështirë për ne", u shpreh Xavi në konferencën për shtyp duke zbuluar më pas se çfarë i tha presidenti Laporta: "Ai më tha se kjo është e tepruar. Është një zhgënjim i madh. Ishte një ndeshje në shtëpi. Duhej ta fitonim për ta vazhduar luftën".

Mourinho në Bayern?

Trajneri Jose Mourinho mund ta marrë drejtimin e Bayern Munchenit. Në fakt, gazetari i njohur "Bild", Christian Falk, ka konfirmuar se trajneri portugez, që pas shkarkimit nga Roma, ka filluar ta studiojë gjuhën gjermane. Gazetari Falk njihet si një gazetar me informacione të shumta brenda klubit gjerman dhe të gjithë mendojnë tashmë se portugezi është në kontakte me "bavarezët". Në anën tjetër Tuchel rrezikon të shkarkohet seriozisht që pas humbjes që pësoi Bayerni në fundjavë nga Bayer Leverkuseni (3-0).

Lëndohet Morata, mungon ndaj Interit

Sulmuesi Alvaro Morata është lënduar gjatë sfidës ndaj Sevilas (1-0), në "Ramon Sanchez Pizjuan". Atletico Madrid ka dalë me një deklaratë zyrtare lidhur me dëmtimin e sulmuesit, duke njoftuar se ai do ta humbasë ndeshjen ndaj Interit. "Pas ekzaminimeve mjekësore, vihet re një dëmtim në ligamentet anësore të gjurit të djathtë. Koha e rikuperimit ende nuk është e përcaktuar", thuhet në njoftimin e klubit spanjoll. Kështu, Morata do ta humbasë ndeshjen e parë të fazës së 1/16-ve ndaj Interit, por klubi është optimist se spanjolli do të jetë i grumbulluar për ndeshjen e kthimit në Madrid më 13 mars.

Trajneri i Gironës: Vinicius është më i miri në botë

Trajneri i Gironës, Michel, pas humbjes që pësoi skuadra e tij nga Real Madridi me rezultat 4-0, ka thënë se Vinicius Junior është lojtari më i mirë në botë kur bëhet fjalë për një lojtar kundër një tjetri. "Vinicius është më i miri në botë kur bëhet fjalë për një kundër një. Vinicius Junior", ka thënë Michel. "Vinicius mund të të fundosë. Ai i detyron ekipet të vendosin 8 lojtarë pas topit", u shpreh Michel. Vinicius në ndeshjen ndaj Gironës shënoi një gol dhe kontribuoi në tre të tjerë.

Pioli: Fitorja ndaj Napolit ishte e merituar

AC Milan e mposhti Napolin në "San Siro" me rezultatin minimal 1-0, duke konfirmuar sërish një formë të shkëlqyer në Serinë A. Trajneri Stefano Pioli ka thënë se

kuqezinjët e fituan me meritë këtë ndeshje. "Nuk e di nëse kemi bërë më të mirë, por në këtë muaj e gjysmë ne kemi bërë shumë mirë dhe pothuajse kemi mbajtur

ritmin e Interit. Do të përpiqemi t'i fitojmë të gjitha. Tani po vjen edhe Liga e Evropës dhe energjia do të shpenzohet më shumë, por ne duam të bëjmë mirë në të dyja

garat. Ne do t'i rishikojmë episodet sepse kishim mundësi për ta dyfishuar rezultatin, por është mirë të fitosh një ndeshje si kjo kundër një ekipi që ka cilësi të shkëlqyera.

Luftuam si ekip dhe ne donim ta fitonim këtë ndeshje. Kjo ishte një fitore e merituar pasi ne djersitëm shumë, përballuam edhe rrezikun e Napolit", u shpreh Pioli.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË-RISHPALLJE

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 01-24

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontratë për përkthim dhe lekturim të dokumenteve të OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tej kalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **23.02.2024 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **27.02.2024 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **27.02.2024 ora 14:00.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “UHB B Creative” SH.P.K. me pronar Valbone Haffke dhe Buen Bajrami, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812071710 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavjanje se svi klienti da drustvo sa “UHB B Creative” D.O.O. sa vllasnikom Valbone Haffke dhe Buen Bajrami, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812071710 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “UHB B Creative” L.L.C. with owner Valbone Haffke dhe Buen Bajrami, has come to the decision to quit its business: 812071710 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Behxhet Canolli B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 811538521.

Njazi Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

Hana Bytyqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

SUMA SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 600036512.

TRE ENGJUJT SH.P.K, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB: 810138900.

Eriad Gashi shpallë të pavlefshme diplomën SHME “Faik Konica”, Ferizaj.

Florand Isufi shpallë të pavlefshme diplomën SHMM “Elena Gjika”, Ferizaj.

Arianit Nuha shpallë të pavlefshme diplomën SHMGJ “Dr. Shaban Hashani”, Ferizaj.

Përparim Bytyqi shpallë të pavlefshme dëftesën e kl 1---8. Shkolla fillore “Mejdi Xhaferi”, Merisal.

Shkurte Sadiku shpallë të pavlefshme diplomën SHME “Faik Konica” Ferizaj.

Elonë Zariqi shpallë të pavlefshme dëftesën e kl 10 11 12 dhe diplomën SHME “Faik Konica” Ferizaj.

Ardiana Ademi shpallë të pavlefshme dëftesën e kl 10 11 12 dhe diplomën SHMM “Elena Gjika” Ferizaj.

Enver Berisha shpallë të pavlefshme diplomën SHME “Faik Konica” Ferizaj.

Resul Emini shpallë të pavlefshme dëftesën e kl 10 11 12 13 dhe diplomën SHMM “Elena Gjika”, Ferizaj.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

